



Bazuar në nenin 5, 14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28, 04 Qershor 2008), nenin 13 paragrafi 1.4 dhe 44 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, nenit 7 të Marrëveshjes së Mirëkuptimit Nr. prot.02 Nr.1467/23 datë 08.12.2023 dhe Nr.01-1747 datë 08.12.2023 si dhe Aneks- Marrëveshjes Nr. prot. Nr.1461/24 datë 29.08.2024 dhe Nr.01-1250 për bashkëfinancim të projektit:

- K.R.U Mitrovica përfaqësuar nga z.Bashkim Kurti, Kryeshef Ekzekutiv (këtu e tutje, KRUM),
dhe
- Komuna e Vushtrrisë përfaqësuar nga z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës (këtu e tutje, Komuna) me datën 04.02.2025 lidhin këtë:

ANEKS-MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR BASHKËFINANCIM TË PROJEKTIT

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është ndryshim plotësimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit Nr. prot.02 Nr.1467/23 datë 08.12.2023 dhe Nr.01-1747 datë 08.12.2023 për bashkëfinancim të projektit "Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në Lagjen Mazhiq në Komunën e Vushtrrisë".

Neni 2 Ndryshim plotësimi

Ndryshim plotësimi i marrëveshjes me numër dhe datë të shënuar bëhet si vijon:

2.1. Neni 2 (Vlera e projektit dhe financimit) tek pika 2.3 Komuna e Vushtrrisë financon me mjete financiare nga buxheti i saj në këtë projekt me 60% ose 25,200.00 € (njëzetepesëmijë e dyqind euro). Këto mjete do të i transferohen KRUM në vitin 2024 ndryshohet me vitin 2025, bazuar në situacionet për punët e kryera që do të raportohen nga menaxheri mbikëqyrës i projektit.

2.2. Te neni 3 (Realizimi i Projektit) " Zgjerimi i rrjetit te ujës-jellës në Lagjen Mazhiq në Komunën e Vushtrrisë" i paraparë për vitin 2024 do të realizohet brenda vitit 2025 , në bazë të projektit zbatues që do ta siguroj KRUM.

2.3. Neni 4 (Obligimet e KRUM-së) tek pika 4.5 KRUM duhet të ndërmerr të gjitha masat që mjetet e ndara nga KRUM për këtë projekt sipas nenin 2 pika 2.2 të kësaj marrëveshje të realizohen gjatë vitit 2025.

Neni 3 Numri i ekzemplarëve

Aneks- Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në tre (3) ekzemplar identik në origjinal, prej të cilëve dy (2) për komunën dhe një (1) për palën tjetër nënshkruese. Marrëveshja përmban 4 nene në katër (4) faqe A/4.


Neni 4 Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje të hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Komuna e Vushtrrisë



z. Ferit Idrizi, Kryetar



Datë 05/09/2025

KRU Mitrovica



z. Bashkim Kurti, Kryeshf Ekzekutiv



Datë ___/___/2025